

## Gjykata Supreme e Kosovës

Ap.-Kž. Nr. 344/2008

20 tetor 2009

Prishtinë

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës në kolegjin e formuar në pajtim me nenin 26, paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), dhe nenit 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë ("Ligji mbi Kompetencat"), të përbërë nga: Maria Giuliana Civinini, Gjyqtare e EULEX-it, si kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese, Guy Van Craen, Gjyqtar i EULEX-it, si anëtar i kolegjit, dhe Fejzullah Hasani, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, si anëtar i kolegjit;

#### Në lëndën kundër të akuzuarve:

**Skender Islami:** me nofkën Buki, shqiptar e Kosovës, i lindur më 13 gusht 1975 në fshatin Braine, Komuna e Podujevës, emri i babait Vesel, mbiemri i vajzërisë së nënës Mehreme Zuka, me vendbanim në Nakarade, Fushë Kosovë, i martuar, tre fëmijë, vozitës i kamionit, ka kryer shkollën e mesme, gjendje të mesme ekonomike me të ardhura që varen nga mundësia për të gjetur punë, më parë nuk ka qenë i dënuar, në paraburgim për këto akuza prej 29 gushtit 2006, momentalisht mbahet në Burgun e Dubravës;

**Mustafa Islami:** me nofkën Tafa, shqiptar i Kosovës, i lindur më 04 qershor 1983, në Nakarade, Fushë Kosovë, emri i babait Sabit, mbiemri i vajzërisë së nënës Selvete Berbatovci, me vendbanim në Nakarade, Fushë Kosovë, vozitës i taxit, i martuar, një fëmijë, ka të kryer shkollën fillore, gjendje të dobët ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë, në paraburgim për këto akuza prej 25 gushtit 2006, momentalisht mbahet në Burgun e Dubravës.

**Ramadan Islami** me nofkën Dani, shqiptar i Kosovës, i lindur më 3 qershor 1982 në Nakaradë, Fushë Kosovë, emri i babait Sabit, mbiemri i vajzërisë së nënës Selvete

Berbatovci, me banim në Nakaradë, Fushë Kosovë, automekanik, i pamartuar, di shkrim-lexim, ka të kryer shkollimin fillor, me gjendje të dobët ekonomike, i dënuar edhe më herët, në paraburgim për këto akuza nga data 25 gusht 2006 deri më 5 dhjetor 2007.

**Omer Sylejmani** nuk ka ndonjë nofkë, shqiptar i Kosovës, i lindur më 14 janar 1985 në Livadhin e Bresjes, Fushë Kosovë, emri i babait Muhamet, mbiemri i vajzërisë së nënës Gjyle Hajdari, me banim në Livadhin e Bresjes, Fushë Kosovës, i papunë, i pamartuar, di shkrim-lexim, ka të kryer shkollimin fillor, me gjendje të dobët ekonomike, në paraburgim nga 25 gushti 2006 deri më 7 qershor 2007, i janë zbatuar masat alternative të përcaktuara me nenin 268.1 të KPPPK-së nga data 7 qershor 2007 deri më 20 dhjetor 2007.

**Gazmend Morina** nuk ka ndonjë nofkë, i lindur në vitin 1982 apo më herët në Fushë Kosovë, emri i babait Sejdi, mbiemri i vajzërisë së nënës Sylvete Shabani, me banim në Fushë Kosovë, punëtor krahu, i pamartuar, nuk di shkrim-lexim, nuk ka ndjekur shkollimin, me gjendje të dobët ekonomike, i padënuar më herët, në paraburgim nga 25 gushti 2006 deri më 7 qershor 2007, i janë zbatuar masat alternative të përcaktuara në nenin 268.1 të KPPPK-së nga data 7 qershor 2007 deri më 20 dhjetor 2007.

Duke vendosur mbi ankesat e paraqitura:

- më 08 prill 2008 nga **avokati mbrojtës Fadil I. Hoxha në dobi të të pandehurit Omer Sylejmani** kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më 25 janar 2008 që shpall të pandehurin fajtor për: katër pika të veprës A) për pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale (pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale neni 200, par. 3 të LPK-së të kryer në bashkëpunim me individë të thesi sipas nenit 22 të KP RSFJ-së, ekuivalent me nenin 320, par. 1 dhe 2 dhe nenin 23 të KPPK-së, katër pika të veprës B) Vepra të rënda penale kundër sigurisë publike (neni 164 par. 1 i LPK-së, e kryer në bashkëpunim me të tjerët sipas nenit 22 të KP RSFJ-së ekuivalent me nenin 291 par. 1, 3&5 dhe nenin 23 të KPPK-së, Veprën C), Nxitje e urrejtjes, përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik neni 1 par. 1.1 dhe 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/4 të kryer në bashkëpunim me individë tjerë nën nenin 22 të KPRSFJ-së ekuivalent me nenin 115 par. 1 dhe 2 dhe nenin 23 të KPPK-së, dhe

shqipton një dënim unik **me tri vjet burgim.**

- më 10 prill 2008 nga **avokatja mbrojtëse Florije Drevinja në dobi të të pandehurit Gazmend Morina** kundër aktgjykimit të përmendur që shpall të pandehurin fajtor për: dy pika të veprës A); dy pika të veprës B); veprën C), dhe shqipton një dënim unik **me dy vjet burgim.**

- më 14 prill 2008 nga **avokati mbrojtës Mentor Neziri në dobi të të pandehurit Mustafe Islami** kundër aktgjykimit të përmendur që shpall të pandehurin fajtor për: gjashtë pika të veprës A); gjashtë pika të veprës B); veprën C), dhe shqipton një dënim unik **me shtatë vjet burgim.**

- më 14 prill 2008 nga **avokati mbrojtës Ferki H. Xhaferi në dobi të të pandehurit Skender Islami** kundër aktgjykimit të përmendur që shpall të pandehurin fajtor për: pesë pika të veprës A); pesë pika të veprës B); veprën C), dhe shqipton një dënim unik **me tetë vjet burgim.**

- më 17 prill 2008 nga **avokati mbrojtës Shpend Krasniqi paraqiti një ankesë në dobi të të pandehurit Ramadan Islami** kundër aktgjykimit të përmendur që shpall të pandehurin fajtor për: tri pika të veprës A); tri pika të veprës B); veprën C), dhe shqipton një dënim unik **me tri vjet burgim.**

Pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore në publik më 20 tetor 2009 në praninë e të pandehurve, avokatëve të tyre mbrojtës, Prokurores publike të EULEX-it Anette Milk dhe Prokurorit publik vendor Besim Kelmendi;

pas këshillimit dhe votimit të kolegjit më 20 qershor 2009;

sipas nenit 426 (1) të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë

## **AKTGJYKIM**

Pjesërisht pranohet ankesa e të pandehurit Skënder Islami, e shpall atë fajtor sa i përket krimit të paraparë në nenin 157 par. 3 lidhur me par. 1 të LPK-së të kufizuar me veprimet e përshkruara në pikën 2.1 dhe pikën 2.4 absorbuar në këtë shkeljen e nenit 200 par. 1 të LPK-së dhe fajtor për krimin e paraparë në Nenin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/4.

Pjesërisht pranohet ankesa e të pandehurit Ramadan Islami, e shpall atë fajtor sa i përket krimit të paraparë në nenin 200 të LPK-së dhe të pafajshëm sa i përket krimit

të paraparë në nenin 157 par. 3 të LPK-së dhe në Nenin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/4.

Pjesërisht pranohet ankesa e të pandehurit Mustafa Islami, e shpall atë fajtor sa i përket krimit të paraparë në nenin 200 të LPK-së dhe të pafajshëm sa i përket krimit të paraparë në nenin 157 të LPK-së dhe në Nenin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/4.

Pranohet ankesa e Gazmend Morinës, e shpall atë të pafajshëm dhe e liron atë nga të gjitha akuzat e veshura ndaj tij.

Pjesërisht pranohet ankesa e Omer Sylejmanit e shpall atë fajtor sa i përket krimit të paraparë në nenin 157 par. 3 të LPK-së të kufizuar me veprimet e përshkruara në pikën 2.4 dhe 2.6 absorbuar në këtë shkeljen e nenit 200 par. 1 të LPK-së dhe të pafajshëm për krimin e paraparë në Nenin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/4.

Për Skënder Islamin gjykata shqipton dënimin me tre (3) vjet burgim për krimin e paraparë me nenin 157 par. 3 lidhur me par. 1, dhe dënimin me dy (2) vjet për krimin e paraparë në Nenin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/4. Sipas nenit 48 par .1 dhe par. 2 të KPRSFJ-së një dënim total prej tre (3) vjet dhe gjashtë muaj shqiptohet ndaj tij. Koha e kaluar në paraburgim është e përfshirë në kohëzgjatjen e dënimit.

Për Mustafa Islamin gjykata shqipton dënimin me një (1) vit e gjashtë muaj për krimin e paraparë me nenin 200 të LPK-së dhe vendosë të përfshijë kohën e kaluar në paraburgim në kohëzgjatjen e dënimit.

Për Ramadan Islamin gjykata shqipton dënimin me një (1) vit e gjashtë muaj për krimin e paraparë me nenin 200 të LPK-së dhe vendosë të përfshijë kohën e kaluar në paraburgim në kohëzgjatjen e dënimit.

Për Omer Sylejmanin gjykata shqipton dënimin me dy (2) vjet e gjashtë muaj burgim për krimin e paraparë me nenin 157 par. 3 lidhur me par. 1 dhe vendosë të përfshijë kohën e kaluar në paraburgim në kohëzgjatjen e dënimit.

Gjykata vendosë se të pandehurit Skënder Islami, Mustafa Islami, Ramadan Islami, Omer Sylejmani duhet të kompensojnë bashkërisht shpenzimet e procedurave gjyqësore.

Gjykata revokon vendimin e shkallës së parë mbi kërkesat pronësore dhe udhëzon palët e dëmtuara ti ushtrojnë kërkesat e tyre pronësore në çështje civile gjyqësore.

Urdhëron ndërprerjen e menjëhershme të paraburgimit dhe lirimin e Mustafa Islamit, nëse nuk janë në paraburgim për ndonjë arsye tjetër, siç thuhet edhe në aktvendimin e veçantë.

## ARSYETIMI

### Historia e procedurës

Prokurori publik i UNMIK-ut më 20 shkurt 2007 ka paraqitur aktakuzën kundër Skender Islamit, Mustafa Islamit, Ramadan Islamit, Omer Sylejmanit, Gazmend Morinës duke i akuzuar të pandehurit për pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale (pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale) (neni 200, par. 3 të LPK-së të kryer në bashkëpunim me individë të thesi sipas nenit 22 të KP RSFJ-së, ekuivalent me nenin 320, par. 1 dhe 2 dhe nenin 23 të KPPK-së, Vepra A), pikat 1 deri më 8 Vepra të rënda penale kundër sigurisë publike (neni 164 par. 1 i LPK-së, e kryer në bashkëpunim me të tjerët sipas nenit 22 të KP RSFJ-së ekuivalent me nenin 291 par. 1, 3&5 dhe nenin 23 të KPPK-së, Vepra B, pikat 1 to 8), Nxitje e urrejtjes, përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik (siç përcaktohet me nenin 1 par. 1.1 dhe 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/4 të kryer në bashkëpunim me individë tjerë nën nenin 22 të KPRSFJ-së ekuivalent me nenin 115 par. 1 dhe 2 dhe nenin 23 të KPPK-së, vepra C/pika 9).

Duke u bazuar në rikonstruktimin e fakteve nga ana e prokurorit publik, gjatë trazirave në Fushë Kosovë më 17 mars 2004, Skender Islami, Mustafa Islami, Ramadan Islami, Gazmend Morina dhe Omer Sylejmani janë identifikuar si kryerësit më aktiv dhe udhëheqës të trazirave. Skender Islami sillej përreth me motoçikletë dhe nxiste dhe shtynte grupin. Protestuesit të udhëhequr nga të pandehurit kanë sulmuar, gjuajtur me gurë dhe kanë djegur shtëpinë dhe restorantin Zivin Gaj, në pronësi të Miroslav Velickovicit, Serb nga Bresja, Fushë Kosovë. Pas djegies së restorantit Zivin Gaj protestuesit vazhduan dhe dogjën një kioskë që gjendet para restorantit Zivin Gaj pronë e Zoric Stojanka, edhe një Audi 80-1.6 S me targa 334-KS-540 pronë e Serbit Simic Grujica, të dyja palët e dëmtuara janë të etnisë serbe. Pastaj protestuesit të udhëhequr nga të paditurit kanë plaçkitur dhe djegur Spitalin e serbeve në fshatin Bresje, dhe pastaj edhe qendrën shëndetësore e cila gjendej në të njëjtin oborr me spitalin. Në të njëjtën ditë rreth orës 16:00, një grup i protestuesve të udhëhequr nga të pandehurit e lartpërmendur kanë sulmuar shtëpinë e Milomir

Mitrovicit, kanë tërhequr zvarrë një veturë Yugo Florida e cila gjendej në garazh e kanë shtyrë në drejtim të ndërtesës së Postës dhe e kanë djegur atë. Përderisa vetura po digjej ajo është rrokullisur deri te ndërtesa e PTT-së dhe kjo ka shkaktuar djegien e PTT-së gjithashtu. Protestuesit kanë shkaktuar dëm të madh duke vjedhur në ndërtesën e PTT-së. Rreth orës 17:00 protestuesit të udhëhequr nga të pandehurit e lartpërmendur kanë hyrë në shkollën Sveti Sava, që u shkatërrua dhe u djeg.

Në seancën për konfirmimin e aktakuzës kundër të pandehurve, të pandehurit e lartpërmendur, më 6 qershor është lëshuar aktvendimi për ndarjen e procedurës kundër dy të pandehurve Omer Sylejmanit dhe Gazmend Morinës nga tre të pandehurit tjerë nga Gjyqtari për konfirmim i cili ka kërkuar informata shtesë nga Prokurori lidhur me moshën e dy të pandehurve. Aktakuza kundër Skender Islamit, Mustafa Islamit dhe Ramadan Islamit është konfirmuar më 04 korrik 2007, pasi që prokurori publik verbalisht ka ndryshuar aktakuzën duke tërhequr akuzën për “udhëheqje të grupit që kryen veprë penale”; Aktakuza kundër Gazmend Morinës dhe Omer Sylejmanit është konfirmuar më 29 gusht 2007. Më 24 shtator 2007 në aktvendimin e lëshuar nga kolegji prej tre gjyqtarëve, procedura penale kundër Gazmend Morinës dhe Omer Sylejmanit është ribashkuar me procedurën penale kundër Skender Islamit, Ramadan Islamit dhe Mustafa Islamit dhe i është referuar si P. Nr. 75/07.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 22 tetor 2007, dhe ka vazhduar më 15, 21, 22, 23, 29 nëntor 2007, 03 dhjetor 2007 dhe 15, 18, 21, 22, 23, 24 janar 2008 dhe aktgjykimi është shpallur më 25 janar 2008.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë shpalli:

- **Skender Islamin fajtor** për: - 5 (pesë) pika të veprës A (Djegien e shtëpisë dhe restorantit të Velickovicit, Kioskën dhe mallin e Stojankës, Djegien e Audi 80 të Simicit, Djegien dhe plaçkitjen e Spitalit serb dhe Djegien e shtëpisë së shëndetit) për të cilat ka shqiptuar dënimin me 5 vjet burgim.- 5 (pesë) pika të veprës B) (faktet e njëjta me veprën A) për të cilat ka shqiptuar dënimin me 5 vjet burgim; - për veprën penale C) për të cilat ka shqiptuar dënimin me 5 vjet burgim. Për veprat penale të lartpërmendura është shpallur një dënim unik dhe i akuzuari është dënuar me **tetë vjet burgim**. Ky aktgjykim i njëjtë shpalli të akuzuarin të pafajshëm për tri pika të veprës A) dhe tri pika të veprës B) (Sulm në shtëpinë dhe vozitjen e veturës Yugo të Mitrovicit, Djegien e Yugos dhe ndërtesës së PTT-së dhe vjedhjen e parave dhe mallit tjetër, Shkatërrimin dhe djegien e shkollës Sveti Sava) .

- **Mustafa Islamin fajtor** për: - 6 (gjashtë) pika të veprës A) (faktikisht 7: Djegien e shtëpisë dhe restorantit të Velickovicit, Sulm në shtëpinë dhe vozitjen e veturës Yugo të Mitrovicit, Djegien e Yugos dhe ndërtesës së PTT-së dhe vjedhjen e parave dhe mallit tjetër, Djegien dhe plaçkitjen e Spitalit serb dhe Djegien e shtëpisë së shëndetit, Shkatërrimin dhe djegien e shkollës Sveti Sava) për të cilat ka shqiptuar dënimin me 5 vjet; për gjashtë pika (faktet e njëjta të shënuara më lart) të veprës B) për të cilat ka shqiptuar dënimin me pesë vjet burgim; - veprën C) për të cilën ka shqiptuar dënimin me 5 vjet burgim. Për veprat penale të lartpërmendura është shpallur një dënim unik dhe i akuzuari është dënuar me **shtatë vjet burgim**. Ky aktgjykim i njëjtë shpalli të akuzuarin të pafajshëm për një pikë të veprës A) dhe një pikë të veprës B) (Djegien e Audi 80 të Simicit).

- **Ramadan Islamin fajtor** për: - 3 (tri) pika të veprës A) (Djegien e Yugos dhe ndërtesës së PTT-së dhe vjedhjen e parave dhe mallit tjetër, Djegien dhe plaçkitjen e Spitalit serb dhe Djegien e shtëpisë së shëndetit,) për të cilat ka shqiptuar dënimin me një vit burgim, - 3 (tri) pika (faktet e njëjta të shënuara më lart) të veprës B) për të cilat ka shqiptuar dënimin me një vit burgim; - veprën C) për të cilën ka shqiptuar dënimin me dy vjet burgim. Për veprat penale të lartpërmendura është shpallur një dënim unik dhe i akuzuari është dënuar me **tre vjet burgim**. Ky aktgjykim i njëjtë shpalli të akuzuarin të pafajshëm për dy pika të veprës A) (Djegien e Audi 80 të Simicit, Shkatërrimin dhe djegien e shkollës Sveti Sava) dhe dy pika (të njëjta) të veprës B).

- **Omer Sylejmanin fajtor** për: - katër pika të veprës A) (Sulm në shtëpinë dhe vozitjen e veturës Yugo të Mitrovicit, Djegien e Yugos dhe ndërtesës së PTT-së dhe vjedhjen e parave dhe mallit tjetër, Djegien dhe plaçkitjen e Spitalit serb, Shkatërrimin dhe djegien e shkollës Sveti Sava) për të cilat ka shqiptuar dënimin me një vit burgim; - katër pika të veprës B) (faktet e njëjta) për të cilat ka shqiptuar dënimin me dy vjet burgim; - veprën C) për të cilën ka shqiptuar dënimin me dy vjet burgim. Për veprat penale të lartpërmendura është shpallur një dënim unik dhe i akuzuari është dënuar me **tre vjet burgim**. Ky aktgjykim i njëjtë shpalli të akuzuarin të pafajshëm për një pikë të veprës A) dhe një pikë të veprës B) (Djegien e shtëpisë së shëndetit)

- **Gazmend Morinën fajtor** për: - dy pika të veprës A) për të cilat ka shqiptuar dënimin me një vit burgim; - dy pika të veprës B) (faktet e njëjta) për të cilat ka shqiptuar dënimin me një vit burgim; - veprën C) për të cilën ka shqiptuar dënimin me

një vit burgim; Për veprat penale të lartpërmendura është shpallur një dënim unik dhe i akuzuari është dënuar me **dy vjet burgim**. Ky aktgjykim i njëjtë shpalli të akuzuarin të pafajshëm për katër pika të veprës A) dhe për katër pika të veprës B) (Sulm në shtëpinë dhe vozitjen e veturës Yugo të Mitrovicit, Djegien e Yugos dhe ndërtesës së PTT-së dhe vjedhjen e parave dhe mallit tjetër, Djegien dhe plaçkitjen e Shtëpisë së Shëndetit, Shkatërrimin dhe djegien e shkollës Sveti Sava).

Të pandehurit janë obliguar të paguajnë shpenzimet e procedurës penale. Paraburgimi ndaj dy të pandehurve të parë është zgjatur nga kolegji derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, kurse tre të pandehurit tjerë u liruan derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Pas shpalljes së aktgjykimit më 25 janar 2008, të pesë avokatët mbrojtës shprehën dashjen që të paraqesin ankesë kundër aktgjykimit, që edhe e bënë siç është veçuar edhe në titullin e këtij aktgjykimi.

**Avokati mbrojtës Ferki Xhaferi në dobi të të pandehurit Skender Islami** mbështet ankesën e tij në bazë të a) *Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale*, b) *vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*, c) *shkeljes së ligjit penal*, d) *vendimit mbi dënimin dhe mbi shpenzimet e procedurës dhe pagesën e dëmit të shkaktuar në palët e dëmtuara*, e) *vendimit mbi shpalljen e aktgjykimit të media*. Avokati propozon Gjykatës Supreme që të kthejë lëndën për rigjykim, apo të ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe të shpallë të pandehurin të pafajshëm.

**Avokati mbrojtës Mentor Neziri në dobi të të pandehurit Mustafa Islami** mbështet ankesën e tij në bazë të a) *vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*, b) *vendimit mbi dënimin dhe c) vendimin mbi kërkesën pronësore*. Avokati propozon Gjykatës Supreme që të lirojë klientin e tij nga të gjitha akuzat, apo të kthejë lëndën për rigjykim, apo të ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë për një dënim më të favorshëm dhe më të butë.

**Avokati mbrojtës Shpend Krasniqi në dobi të të pandehurit Ramadan Islami** mbështet ankesën e tij në bazë të a) *vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*, b) *vendimit mbi dënimin dhe c) vendimit mbi pagesën e dëmit të shkaktuar në palët e dëmtuara*. Avokati propozon Gjykatës Supreme që të ndryshojë aktgjykimin dhe të lirojë klientin e tij nga të gjitha akuzat, apo të kthejë lëndën për rigjykim apo të shpallë një dënim më të butë.

**Avokati mbrojtës Fadil Hoxha, në dobi të të pandehurit Omer Sylejmani,**

mbështet ankesën e tij në bazë të a) *Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale*, b) *vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*, c) *shkeljes së ligjit penal*, d) *vendimit mbi dënimin dhe mbi shpenzimet e procedurës dhe pagesën e dëmit të shkaktuar në palët e dëmtuara*. Avokati propozon të pranohet ankesa e tij dhe të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dërgohet lënda për rigjykim dhe vendim të ri, apo të lirojë klientin e tij nga të gjitha akuzat, apo të shqiptojë lirim me kusht duke përfshirë edhe kohën e kaluar në paraburgim.

**Avokatja mbrojtëse Florije Drevinja, në dobi të të pandehurit Gazmend Morina** mbështet ankesën e saj në faktin se aktgjykimi nuk i përshtatet gjendjes mendore të klientit të saj, pasi që ai është një njeri me një zhvillim të dobët mendor, duke pretenduar se klienti i saj nuk ka mundur të kuptojë çështjen e as të kuptojë lidhjen me veprat për të cilat ai është dënuar. Avokati i propozon Gjykatës Supreme të lirojë klientin e saj nga burgimi apo të lëshojë një aktgjykim lirimi me kusht.

Lënda është bartur nga Gjyqtarët e UNMIK-ut tek EULEX-it më 20 janar 2009.

Në shqyrtimin e datës 20 tetor 2009, pasi janë dëgjuar argumentet e avokatëve mbrojtës, të pandehurve dhe të Prokurorit publik, Gjykata vendosi dhe shpalli aktgjykimin publikisht.

### **1. Arsyet**

Vërejtje paraprake.

Avokatët mbrojtës dhe të pandehurit nuk e kontestojnë se më 17 mars, në Fushë Kosovë kanë ndodhur një seri e ngjarjeve të dhunshme.

Grupi i përbërë nga mijëra njerëz janë mbledhur në rrugë qysh në orët e para të pasdites duke u bërë gjithnjë e më agresiv. Grupe të shqiptarëve dhe serbëve filluan të ballafaqohen dhe përleshën; veturat, shtëpitë, ndërtesat private dhe shoqërore në pronësi të serbëve u sulmuan dhe dogjën nga grupi i cili vepronte si grup i bashkuar. Ishte e pamundur për Policinë që ti ndalonte trazirat apo të parandalonte kryerjen e veprave penale rënda; në të vërtetë, vetëm 7 Policë të Stacionit Policor në fushë Kosovë ishin të pranishëm gjatë orëve kritike në të cilat janë kryer krimet më të rënda dhe janë shkaktuar dëmet më të mëdha; Policët e UNMIK-ut kanë arritur në vendin e ngjarjes më vonë rreth orës 17:00.

Duke u përqendruar në faktet e marra parasysht në këtë procedurë, nuk kontestohet se

më 17 mars 2004: shtëpia e Zivin Gaj restoranti pronë e Miroslav Velickovic ishin sulmuar, gjuajtur me gurë dhe djegur; kiosku i cili gjendej përball restorantit Zivin Gaj pronë e Zoric Stojanka është djegur më tërë mallin brenda tij; vetura Audi 80, ne targa 334-KS-540 pronë e Simic Grujica është djegur; Spitali Rus është gjuajtur me gurë, okupuar dhe djegur, duke i shkatërruar të gjitha pajisjet repartit interno, neurologjisë, fizioterapisë; shtëpia e shëndetit e cila gjendet në të njëjtin oborr me Spitalin është djegur; shkolla Sveti Sava është shkatërruar dhe djegur; shtëpia e Milomir Mitrovic është sulmuar dhe vetura e tij Yugo Florida me targa 334-KS-664 është tërhequr, shtyrë në drejtim të ndërtesës së Postës dhe është djegur duke i vënë zjarr edhe ndërtesës së PTT-së; mallrat që kanë qenë brenda ndërtesës së PTT-së janë vjedhur dhe shkatërruar.

Çfarë kontestohet është pjesëmarrja e të pandehurve në trazira dhe përgjegjësia e pjesëmarrësve për veprimet e listuara kriminale.

**2. Rikonstituimi i fakteve të bazuara në deklaratat e të dyshuarve të mitur ptë dhëna në Polici**

Në Ankesat e tyre, avokatët mbrojtës pretendojnë se gjykata e shkallës së parë ka bazuar vendimin e saj për dënimin e të pandehurve në dëshmi të papranueshme të mbledhura në shkelje të neneve 152, 153, 154, 356, 364, 368, 371, 387 të KPPK-së.

Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i datës 25 janar 2008, rikonstrukton faktet në bazë të: - dëshmime të Policëve të pranishëm në Fushë Kosovë gjatë trazirave, apo gjatë intervistimit të të dyshuarve; - dëshmime të një grupi të të rinjve të pranishëm në Fushë Kosovë gjatë trazirave. Secili dëshmitar nga grupi i dytë (me përjashtim të Shpresa Hazirit) janë intervistuar (në shumicën e rasteve, dy apo tri herë) si të “dyshuar” nga ana e Policisë (procesverbali deklaratave, kutia “i dyshuar” është nënvizuar; formulari mbi të drejtat e të dyshuarit/pandehurit përfshirë edhe heqjen dorë nga ndihma e avokatit janë të bashkangjitura në këtë procesverbal të nënshkruar nga të intervistuarit dhe Polici i PK-së .)

Gjatë shqyrtimit gjyqësor procesverbali i këtyre intervistave është përdorur (natyrisht në një mënyrë të përgjithësuar pa i tërhequr vëmendjen dëshmitarëve lidhur me deklaratat e mëparshme) për kundërshtimin e deklaratave të dëshmitarëve në shqyrtim. Secili dëshmitar . . . - procesverbali i gjykimit 22 nëntor 2007 —

AJ E2  
-procesverbali i gjykimit 22 nëntor 2007 - - procesverbali i  
gjykimit 22 nëntor 2007 - - procesverbali i gjykimit 22 nëntor 2007 -  
42 - procesverbali i gjykimit 22 nëntor 2007 -  
procesverbali i gjykimit 15 nëntor 2007 - - procesverbali i gjykimit 15  
nëntor 2007 - - procesverbali i gjykimit 15 nëntor 2007 -

- procesverbali i gjykimit 21 nëntor 2007) kanë njohur nënshkrimet e tij/saj në  
procesverbal, mirëpo kanë tërhequr (tërë) përmbajtjen e deklaratave (. dhe  
tanimë ishin tërhequr para prokurorit më 12 dhe 25 tetor 2006) duke pohuar se  
ajo nuk kishte pasur mundësin që ti lexoj ato pasi që kishte qenë shumë e frikësuar  
dhe se kishte qenë e detyruar nga Policia që ti nënshkruaj nën kërcënim apo pasi që  
ishin rrahur. Në veçanti, të gjithë mohuan se i kanë njohur të pandehurit në grup  
dhe/ose ti kenë parë ata duke kryer veprimet relevante. Procesverbali i intervistave të  
dëshmitarëve të lartpërmendur pranë Policisë (dhe ajo e rit, i cili jeton  
jashtë vendit nuk është paraqitur në gjykatë) janë pranuar si dëshmi nga gjykata e  
shkallës së parë, me kërkesën e prokurorit publik.

Avokatët mbrojtës në shqyrtimin gjyqësor (shih procesverbalin e shqyrtimit të 22  
nëntorit 2007, faqe 49) në argumentet përmbyllëse (shih procesverbalin e shqyrtimit  
të 23 janarit 2008, faqet 7 dhe 10) dhe në ankesa kanë ngritur përjashtimin e  
papunueshmërisë së deklaratave të mbledhura nga Policia pa ndihmën e obligueshme  
të avokatit dhe pa i siguruar personit të intervistuar në cilësinë e të “dysshuarit”  
informata korrekte lidhur me të drejtat e tyre.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka refuzuar përjashtimin duke vërtetuar se:  
nuk ka asnjë ndalesë ligjore për shfrytëzimin e deklaratës së dhënë nga i dyshuari si  
dëshmi; të dyshuarit janë informuar lidhur me të drejtat e tyre; të pandehurve u është  
dhënë mundësia ti kundërshtojnë deklaratat duke i bërë pyetje dëshmitarëve; “sa i  
përket shfrytëzimit të deklaratave si dëshmi kundër tjerëve, mungesa e informimit  
lidhur me krimin, personat e marrë në pyetje janë dyshuar për dhe heqja dorë nga  
ndihma e avokatit nuk ka ndikim në deklaratat e dhëna në Polici. Këto të drejta janë të  
drejtat e mbrojtjes ë jo të drejtat e dëshmitarit – dhe në këtë rast deklaratat nuk janë  
përdorur kundër personave që i kanë dhënë ato”. (faqe 15).

Gjykata Supreme konstaton se:

1. gjatë kohës së hetimeve, dëshmitari i, V. dhe E. kanë qenë të mitur; ata janë

ekzaminuar bë cilësinë e të dyshuarve me ndihmën e, në mënyrë alternative, të njërit prej kushërinjve të tyre ose të punëtorit social; asnjëri prej tyre nuk është ndihmuar nga avokati duke pasur të mitur – pa pëlqimin e prindërve duke ushtruar autoritetin prindëror dhe me iksin në katrorin e heqjes dorë nga ndihma.

2. ndihma e avokatit është e obligueshme kur i dyshuari apo i pandehuri është i mitur; neni 40 i Ligjit për të Mitur (i cili ka hyrë në fuqi më 20 prill 2004) parasheh që prania e avokatit mbrojtës është e obligueshme pasi që ekzaminimi i parë (përfshirë ekzaminimin në Polici); për periudhën para hyrjes në fuqi të atij Kodi. Prania e avokatit është imponuar (për ekzaminimet e bërë në mes të 1 dhe 5 prillit) me nenin 71 të KPPJ-së dhe (për ekzaminimet në mes të 6 dhe 20 prillit) me nenin 69, paragrafin 3 dhe nenin 73, paragrafin 1, pikën 1 (ekzaminimi i parë i të dyshuarit/ pandehurit “i paaftë për ta mbrojtur vetën në mënyrë efektive”).
3. ekzaminimi i të dyshuarit/pandehurit pa ndihmën e avokatit në rastin e mbrojtjes së obligueshme është joligjore dhe “deklaratat e të pandehurit do të jenë të papranueshme” (neni 235 KPPK-së).
4. sapo të vërtetohet së deklaratat e caktuara janë të papranueshme, ato nuk mund të përdoren si dëshmi në procedurë penale kundër të njëjtit të pandehur e as në procedurë penale kundër dikujt tjetër.
5. arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë (se jo-ligjshmëria e deklaratës nuk është relevante nëse ajo nuk përdoret kundër personit i cili e ka dhënë atë) është i gabuar; kur një dëshmi merret duke mos i respektuar rregullat shkelja e të cilave sanksionohet me papranueshmëri, dëshmia e tillë nuk mund të paraqitet në shqyrtim gjyqësor apo të përfshihet në shkresat e lëndës (shih nenet 153 dhe 154 të KPPK-së).
6. si pasojë, gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin kur ka lejuar prokurorin publik të përdor deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në Polici, të kundërshtoj dëshmitë e dëshmitarëve të njëjtë të dhëna në shqyrtimin gjyqësor; gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka shkelur ligjin kur ka pranuar këto deklarata si dëshmi dhe i ka përdorur ato për të rikonstruktuar faktet.

Duke marrë parasysh se faktet materiale (elementet objektive të krimit) janë përcaktuar në mënyrë të duhur dhe se shkelja e lartpërmendur ndikon vetëm përcaktimin e përgjegjësisë penale individuale, nuk ka nevojë që të kthehet lënda për

rigjykim. Kjo gjykatë mund të vlerësoj përgjegjësinë e të pandehurve në bazë të dëshmimeve të vlefshme, pas përjashtimit të deklaratave të dhëna nga të dyshuarit në Polici, dhe deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në shqyrtimin gjyqësor pasi që prokurori i ka konfrontuar ata me deklaratat e mëparshme që ata i kanë dhënë si të dyshuar.

### **Përgjegjësia penale e të pandehurve**

Nga ky këndvështrim dëshmitë që duhet të merren parasysh janë vetëm deklaratat e Poicëve dhe të <sup>S.H.H</sup> (gjatë hetimeve dhe shqyrtimit gjyqësor) dhe deklaratat e Omer Sylejmanit.

Deklaratat e punëtorit social lidhur me dhunën e mundshme apo kërcënimet gjatë ekzaminimit të të miturve në Polici nuk janë relevante sepse deklaratat e të miturve janë shpallur si të papranueshme.

Deklaratat e dëshmitarëve

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore nuk përmbajne asnjë element që i referohet pjesëmarrjes së të pandehurve në krimet e pretenduara.

Vlen të theksohet se kjo gjykatë nuk ka njohuri se si është përmbyllur procedura kundër të dyshuarve të mitur, me përjashtimin e njërit kundëri dhe

ata janë informuar nga Kryetari i kolegjit në shkallën e parë se akuzat kundër tyre janë hedhur poshtë.

Para ekzaminimit të pozitave individuale të të pandehurve, vlen të nënvizohet se si ka përfunduar hetimi.

Gjatë trazirave vetëm SHPK-ja ka qenë e pranishme për të ruajtur rendin publik dhe për të ndihmuar popullatën e sulmuar (Sabit Hajrizi, 22 nëntor 2007: "Atë ditë, policët ndërkombëtar nuk i janë përgjigjur thirrjeve tona.....Unë isha Polici i vetëm me gradë....Në fillim ne ishim katër Policë dhe më vonë na u bashkëngjitën edhe tre të tjerë kështu u bëmë shtatë..... të tjerët kanë ardhur më vonë për të na ndihmuar, kjo është, ata nuk kanë arritur me kohë. Unë supozoj se e kemi kuptuar përgjigjen time sepse kur më në fund kanë ardhur ata atje shtëpitë tanimë ishin shkatërruar dhe ishin në zjarr.."). Situata ka qenë shumë e rëndë sa që ishte absolutisht e pamundur për shtatë Policët të hetojnë apo identifikojnë pjesëmarrësit (shih deklaratat e: Ismet Ahmetovic, 15 nëntor 2007: "të gjithë banorët e Fushë Kosovës, rreth 4000 deri në 5000 njerëz ishin në rrugë...i tërë qyteti ishte pjesë e protestuesve....më duhet të ju

them se kam qenë të pozitë shumë të rëndë. Ne ishim zënë në mes të dy grupeve. Aty kishte thirrje dhe bërtima nga të dy anët; Gjëja e vetme për të cilën mendonim ishte siguria jonë”; Selatin Prebreza, 21 nëntor 2007: “Grupi ishte në çdokënd”; Sabit Hajrizi, 22 nëntor 2007).

Pastaj, policët ndërkombëtar arritën, hetimet filluar dhe u lansua operacioni “Thor”. Dy ekipe ishin organizuar, njëri i përbërë prej policëve ndërkombëtar i cili merrej me hetimet *strictu sensu*, dhe tjetri i përbërë nga SHPK-ja me funksionet e mbështetjes logjistike: fteat, procesverbalet, leximi i të drejtave të dyshuarve, bërja e pyetjeve të sugjeruara dhe propozuara nga hetuesit të dyshuarve shqiptar (shih deklaratat e Ali Ternavës, 29 nëntor 2007; Safet Jasharit, 21 janar 2008; Bekim Zogianit, 3 dhjetor 2007; Q. Idrizit, 3 dhjetor 2007 .)

Sa i përket vlerësimit të Gjykatës Supreme në bazë të shkresave të lëndës dhe pyetjeve gjatë shqyrtimit gjyqësor, vetëm të dyshuarit e mitur dhe Policët e SHPK-së janë intervistuar; hetuesit janë fokusuar në individë të posaçëm emrat e të cilëve janë përmendur vazhdimisht gjatë intervistave në mënyrë që të vërtetohet prania e tyre në trazira dhe fotografitë e të cilëve (janë përmbledhur në album i cili përmbante disa fotografi) i janë treguar të gjithë atyre të intervistuarve (shih deklaratat: Jakupi, 22 nëntor 2007; Shaip Nura, 21 nëntor 2007).

Me qëllim të përshtatshmërisë, pozita e secilit të pandehur duhet të ekzaminohet veçmas.

**A) Skender Islami:** ai ishte i njohur për policët dhe banorët e Fushë Kosovës për shkak të veprimtarisë së tij si vozitës taksie, dhe ai është dalluar në turmë për shkak të shamisë origjinale të kokës (shall i lidhur në kokë), për shkak të syzeve të tij, për shkak të motorit të cilin ai e përdorte të shkoj poshtë e lartë turmës. Identifikimi i fotografisë së tij e bëri prej Policisë (Sabit Hajrizi, deklarata e 13 prill 2004 dhe 15 mars 2005, seanca dëgjimore e 22 nëntorit 2007; Bekim Halilaj, 21 maj 2004, seanca dëgjimore e 15 nëntorit 2007; Ismet Ahmatovic, 15 maj 2004, seanca dëgjimore e 15 nëntorit 2007; Shaip Nura, 14 maj 2004, seanca dëgjimore e 21 nëntorit 2007) dhe prej <sup>S.H.</sup> (deklarata e 17 majit 2004 dhe 6 prill 2005 dhe seanca dëgjimore e 21 nëntorit 2007: "Gjatë kohës një person kaloi me motor, i cili kishte të veshura të zeza, syze të zeza, i cili është në fotografinë nr. 21, ata e thërrisnin atë Skender në rrugën e Krushevcit dhe ka shtëpi në Nakarade dhe të gjithë personat që ishin përreth automjetit i duartrokitën atij dhe ai e ngriti dorën e tij lart dhe vazhdoi në drejtim të stacionit të trenit") nuk lë hapësirë për dyshim .

Prej dëshmisë së policëve roli aktiv i Skender Islamit u ngrit shumë qartë: ai ishte në linjën e parë të turmës së Shqiptarëve përballë asaj Serbe (Bekim Halilaj, 15 nëntor 2007); ai është parë duke gjuajtur koktejin e mollotovit mbi pullazin e restorantit (Shaip Nura, 14 maj 2004; 21 nëntor 2007), në oborrin e Spitalit Rus duke e përmbysur dhe djegur veturën dhe (Sabit Hajrizi 13 prill 2004 dhe 15 mars 2005, seanca dëgjimore e 22 nëntorit 2007) duke marr pjesë në këtë mënyrë në veprimin që rezultoi në djegien dhe plaçkitjen e spitalit. Nuk ka prova se ai ka marr pjesë në veprimet tjera.

**B) Ramadan Islami:** I pandehuri është parë aktiv në turmë prej policëve, duke shkuar përreth, kryesisht në shoqëri të axhës/dajës Skender Islami dhe vëllait Mustafa (Sabit Hajrizi 13 prill 2004 dhe 15 mars 2005, seanca dëgjimore 22 nëntor 2007, ai i referon Ramadanin dhe Mustafën si anëtar të grupit të Skenderit në oborrin e spitalit; Ismet Ahmatovic, 15 nëntor 2007;)

**C) Mustafa Islami:** I pandehuri është parë aktiv në turmë prej policëve, kryesisht në shoqëri të dajës/axhës së tij Skender Islami dhe vëllait Ramadan (Sabit Hajrizi 13 prill 2004 dhe 15 mars 2005, seanca dëgjimore e 22 nëntorit 2007, ai i referon Ramadanin dhe Mustafën si anëtar të grupit të Skenderit në oborrin e spitalit; Bekim Halilaj, 15 nëntor 2007; Ismet Ahmatovic, 15 nëntor 2007).

**D) Gazmend Morina:** Asnjë prej policëve nuk e ka parë atë gjatë trazirës.

**E) Omer Sylejmani:** Mbrojtësi ngriti një çështje specifike duke e dorëzuar në ankesën e tij që, në kohën e pretenduar të kryerjes së veprës, ky i pandehur ishte i mitur. Pyetja e njëjtë ka qenë e zgjidhur në mënyrë korrekte prej gjykatës së shkallës së parë në fund të vlerësimit të saktë të provave duke e lejuar konstatimin se Omer Sylejmani ka lindur me 14 janar 1985, prandaj ai nuk është më i mitur me 17 mars 2004. Kjo gjykatë e ndau këtë konkluzion në bazë të certifikatës së lindjes nr.. 11-324/85 e lëshuar prej Zyrës së Regjistrimit Civil të Fushë Kosovës me 7 shkurt 1985, të certifikatës së lindjes së UNMIK-ut e lëshuar me 3 korrik 2006, të dhënat personale të dhëna prej të pandehurit në police me 23 gusht 2006.

Asnjë prej policëve nuk e ka identifikuar këtë të akuzuar gjatë trazirës. Ai paraqiti deklaratatë vetë-inkriminuese në polici (23 gusht 2006) por të tërhequra para prokurorëve publik (11 shtator 2006). Ai i deklaroi policisë se ai ishte në turmë që u bashkua te spitali ku një person i panjohur i dha atij një shkrepës duke e shtyrë atë t'i djeg perdet e spitalit, të cilën e bëri, edhe pse menjëherë pas kësaj ai u mundua ta shuaj zjarrin. Ai gjithashtu deklaroi se i ka ndihmuar grupit të protestuesve për

shtyrjen dhe shkatërrimin e veturës afër ndërtesës së postës. Para prokurorit, ai i tërhoqi këto deklaratat duke pranuar se ai ishte në kompleksin e spitalit por pa marr pjesë në veprime por në të kundërtën ai ishte duke u munduar ta shuaj zjarrin. Në shqyrtimin kryesorë (21 janar 2008) ai mohoi çfarëdo pjesëmarrje aktive por pranoi shkuarjen në spital, duke kaluar nëpërmes turmës dhe duke e shuar zjarrin të perdes që digjej e që fluturoi jashtë prej dritares.

Deklaratat e dhëna para policisë janë përdorur prej prokurorit gjatë shqyrtimit kryesorë për të sfiduar deklaratën e të pandehurit dhe pastaj e pranuar si provë prej gjykatës. Mbrojtësi konteston lejueshmërinë e këtyre deklaratave pasi që ato janë mbledhur pa ndihmën e avokatit. Në procesverbalin e intervistës në mënyrë të qartë është shënuar se i pandehuri ishte informuar lidhur me të drejtat e tij dhe ai ka refuzuar praninë e avokatit. Duke mos qenë çështje mbrojtjes së obligueshme, këto deklaratat janë të lejueshme dhe mund të përdoren si dëshmi.

Gjykata Supreme konsideron se deklaratat vetë-inkriminuese të dhëna prej të pandehurit, me të cilat ai ishte ballafaquar gjatë shqyrtimit kryesorë, është dëshmi valide e pjesëmarrjes së tij në trazirë. Ky konkluzion është përforcuar me deklaratat të dhëna para prokurorit dhe gjatë shqyrtimit kryesorë, ku i akuzuari pranoi të jetë pjesë e turmës në oborrin e spitalit (duhet të theksohet që nuk është bindëse që në atë situatë dhe në mes të turmës së dhunshme ai ishte atje vetëm të shuaj zjarrin e dhënë në perde).

Përfundimisht vlen të mbahet në mend se i pandehuri ishte subjekt i ekspertizës psikiatrike e cila e definoi atë si person pa sëmundje apo çrregullim mendor, akut apo kronik.

Në bazë të elementeve të përmendura më lart, gjykata përfundon se Gazmend Morina duhet të lirohet prej të gjitha akuzave të ngritura ndaj tij.

Ndonëse për veprën penale të nxitjes së urrejtjes përçarjes ose mosdurimit Kombëtar, Racor, Fetar dhe Etnik.(Neni 1 paragrafi .1.1 dhe 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/4 e kryer në bashkëpunim me personat tjerë), Gjykata Supreme konsideron se dëshmi të kryerjes së këtij krimi ekziston vetëm për Skender Islamin.

Trazira e marsit 2004 kishte një konotacion etnik. Kjo shfaqet qartë prej dëshmive të policëve (në mes tyre: Bekim Halilaj, 15 nëntor 2007: "Më kujtohet se turma ishte duke kënduar këngë patriotike. Kishte thirrje për lirimin e rrugës dhe gjithashtu thirrje lidhur me fëmijët e fundosur në lumin Ibër"; Ismet Ahmatovic, 15 nëntor 2007: dy

turma, një e Serbëve dhe tjetra e Shqiptarëve, ishin duke e ballafaquar njëra-tjetrën; Sabit Haziri , 22 nëntor 2007: shumica e protestuesve ishin shqiptarë; turma sulmoi shtëpitë serbe; shih gjithashtu deklaratat Sylejmani, 21 janar 2008) dhe prej caqeve të turmës, shtëpitë dhe pronat serbe, spitali rus, ndërtesa e postës.

Skender Islami ishte përshkruar prej të gjithë dëshmitarëve si një prej më aktivëve në turmë, ai ishte parë në pjesë të ndryshme të zonës të interesuar prej trazirës, duke e marrë me vete një grup të njerëzve duke përfshirë dy nipat, duke shkuar përreth në motorin e tij në mes të ovacioneve të turmës, duke nxitur përçarje kombëtare dhe urrejtje etnike. Veprimet e tij demonstrojnë se ai ishte mirë i vetëdijshëm për rolin e tij.

Prej dëshmitarëve është raportuar se Ramadani, Mustafa dhe Omeri ishin aktiv në turmë mirëpo pa qëndrime apo sjellje nxitëse prej anës së tyre. Si pasojë ata duhet të lirohen prej akuzave.

Sa i përket veprave penale të pjesëmarrjes në turmë duke kryer vepër penale dhe veprime serioze penale kundër sigurisë publike, Gjykata Supreme konsideron se dy krime të barabarta mund të mos kryhen në të njëjtën kohë me veprime të njëjta..

Neni 200 i LPK-së dënon për pjesëmarrje të dukshme "kushdo që merr pjesë në grup që përmes veprimit të përbashkët privon jetën e personit tjetër apo i shkakton lëndime serioze trupore atij personi, kryen zjarrvënie, dëmton pronën në mënyrë të konsiderueshme apo kryen dhunë tjetër të rëndë, apo i cili/cila tenton të kryej vepra të tilla"; neni. 157 paragrafi 1 LPK dënon "cilindo që me zjarrvënie, përmbytje, shpërthim, helm apo gaz helmues, rrezatimi jonizues, fuqi motorike apo elektrike apo me çfarëdo veprimi të përgjithshëm të rrezikshëm apo të mjeteve të përgjithshme të rrezikshme, rrezikon jetën njerëzore apo të trupit të pasurisë së konsiderueshme" dhe paragrafi 3 specifikon dhënien e ndëshkimit më të lartë "Nëse veprimet prej paragrafit 1 ... janë kryer në vendin ku një numër i madh i personave janë mbledhur...". Neni 157, paragrafi 1 dhe 2 dënon atë/ate, që është pjesë e grupit/turmës, kryen vepra penale duke e rrezikuar sigurinë publike përderisa neni 200 dënon prezencën e thjeshtë aktive (domethënë, me vetëdije dhe dëshirë) në grup/turmë veprimet e të cilëve shpijnë në veprën penale.

Kur pjesëmarrësi i turmës pranon – siç është rasti i Skender Islamit dhe Omer Sylejmanit – zjarrvënës dhe rrezikues të jetës njerëzore apo të pronës së konsiderueshme, vepra penale e pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale është e konsumuar prej veprës penale të shkaktit të rrezikut të përgjithshëm.

E specifikuar (tashmë në aktgjykimin e shkallës së parë , faqe 12) se veprimet komplekse të vëna në barrë të pandehurve në secilën pikë (1 deri 8) nuk janë krime autonome por vepra penale unike komplekse, Skender Islami është shpallur fajtor në lidhje me krimin e veprimeve serioze penale kundër sigurisë publike e kufizuar në veprimet e përshkruar në pikën 2.1 dhe në pikën 2.4 e absorbuar në këtë shkelja e veprës penale të pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale; Omer Sylejmani është shpallur fajtor në lidhje me krimin e veprave të rënda penale kundër sigurisë publike të kufizuar me veprimet e përshkuara në pikën 2.4 dhe në pikën 2.6 e absorbuar në këtë shkelje të veprës penale të pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale.

Ramadan dhe Mustafë Islami thjeshtë kanë marr pjesë në turmë, në mënyrë aktive, duke pasuar "lëvizjet" e tyre dhe dajës/axhës së tyre Skenderit. Të dytë janë fajtorë në lidhje me krimin e pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale dhe të pafajshëm në lidhje me krimin e veprës së rëndë penale kundër sigurisë publike.


Ndëshkimet siç janë specifikuar në diapozitiv janë të vendosur duke marr parasysh: në një të pandehurit kurrë nuk janë dënuar më parë dhe se ata nuk kanë kryer asnjë vepër të re pas 17 marsit 2004; në anën tjetër seriozitetin objektiv në kontekstin e veprimeve të tyre dhe shkallën e kontributit të tyre.

Skender Islami, Mustafa Islami, Ramadan Islami, Omer Sylejmani duhet ti kompensojnë së bashku shpenzimet e procedurave.

Duke mos pasur dëshmi të mjaftueshme në sasinë e dëmeve të provokuara prej të pandehurve, vendimet e shkallës së parë mbi kërkesat pronësore duhet të revokohen dhe palët e dëmtuara të udhëzohen që kërkesat e tyre pronësore ti ndjekin përmes çështjeve gjyqësore civile.

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar

Më datë 20 tetor 2009  
**Ap-Kz. Nr. 344/2008**



Kryetarja e kolegjit

Procesmbajtëse

\_\_\_\_\_  
Maria Giuliana Civinini,


\_\_\_\_\_  
Edita Kusari,



Anëtar i Kolegjit

\_\_\_\_\_  
Guy Van Craen,

Anëtar i Kolegjit

\_\_\_\_\_  
Fejzullah Hasani,

Republika e Kosovës  Republika Kosovo  
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TACNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar  
Ovlašćeni radnik  
  


Mjeti juridik: Nuk mund të paraqitet ankesë kundër këtij aktgjykimi (neni 430 i KPPK-së). Vetëm kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet pranë gjykatës e cila e ka lëshuar vendimin në shkallën e parë brenda 3 muajve nga dorëzimi i këtij vendimi. (nenet 451 – 460 të KPPK-së).